



REVISTA NR.16



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



ANGAZHIMI QYTETAR PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË

DMirëserdhët në numrin e ri të revistës Civica mobilitas, “Qytetarët për ndryshim”, lajmëtar i programit për mbështetjen e shoqërisë civile të mbështetur nga Qeveria e Zvicrës, por edhe lajmëtar i gjithë shoqërisë civile.

Pas një pauze gati një vjeçare, po i rikthehemi temave dhe nismave që e formësojnë shoqërinë tonë. Ky numër është i mbushur me histori frymëzuese të angazhimit qytetar dhe pjesëmarrjes qytetare kushtuar sfidave mjedisore, të drejtave të grave, arsimit dhe më shumë.

Në një kohë të krizës mjedisore në rritje, Maqedonia po përballet me sfida serioze si ndotja e ajrit, menaxhimi joadekuat i mbeturinave dhe ndryshimet klimatike. Në këtë numër do të lexoni për konferencën e organizuar nga Instituti për Studime të Komunikimit, ku ekspertë dhe aktivistë diskutuan për rëndësinë e komunikimit efektiv mjedisor dhe rolin e qytetarëve në ruajtjen e natyrës. Gjithashtu, i lëmë hapësirë Deklaratës për mbrojtjen aktive të mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, e cila është nënshkruar nga kryetarët e komunave të vendit.

Marshi tradicional i 8 Marsit këtë vit u zhvillua me moton “Të drejtat e grave nuk janë të negociueshme”. Aktivistët bënë thirrje për veprim për të avancuar shëndetin, arsimimin dhe të drejtat ekonomike të grave. Ata i theksuan tetë vija të kuqe që i përshkruajnë ndryshimet e kërkuara, duke përfshirë pagën e barabartë për punë të barabartë dhe një zgjidhje sistematike për aksesin në lejen e paguar të lehonisë për gratë fermere.

Nevoja që arsimit i lartë të integrohet në flukset ekonomike të shtetit u diskutua gjatë forumit tematik “Pamje e dendur: për nevojën e rrjetëzimit të arsimit, shkencës dhe ekonomisë së bazuar në inovacion”.

Ekspertë dhe përfaqësues nga sektori akademik dhe të biznesit diskutuan për nevojën e rrjetëzimit të arsimit, shkencës dhe ekonomisë së bazuar në inovacion.

Ky numër i referohet edhe nismës për rrjetëzimin e organizatave që ofrojnë shërbime sociale, punëtori për nxënësit e shkollave të mesme për dhunën e bashkëmoshatarëve, aksionin për monitorimin e qendrave të votimit dhe aksesin e tyre për personat me aftësi të kufizuara etj.

Ne besojmë se kemi ofruar një larmi përmbajtjesh që i plotëson interesat e lexuesve tanë. Ato i pasqyrojnë përpjekjet e organizatave të shoqërisë civile për të përmirësuar shoqërinë tonë dhe tregojnë se ndryshimet janë të mundshme.

Edhe ju mund të kontribuoni në edicionet e ardhshme të “Qytetarët për ndryshim”. Na shkruani dhe na dërgoni informacione për aktivitetet dhe arritjet tuaja, histori interesante për përdoruesit tuaj ose iniciativat që keni nisur. Le t’i ndajmë informacionet sepse ia vlen kur të arrijnë atje ku duhet.

Lexim të këndshëm!

Gonce Jakovleska

Koordinator kombëtar i Civica mobilitas për IKO

Falënderojmë: Këshillin për Etikë në Media, Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë, Forumin për Politika të Arsyeshme (FRP), Institutin për Politikë Evropiane (EPI), Institutin për Studime të Komunikimit (IKS), HERA – Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hulumentim, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD), Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), Instituti Maqedonas për Media (MIM), Shoqata e qytetarëve Media Plus Shtip, Ambasada e Fëmijëve Megjashi, Eko-vetëdija për mbështetjen dhe qasjen në informata gjatë përgatitjes së teksteve për këtë çështje.

Foto arkivi: Shoqata e qytetarëve Media Plus Shtip, IKS, FRP, EPI, SOS Fshati i Fëmijëve, Ndryshimet Klimatike, Ambasada e Fëmijëve Megjashi, Qendra për Hulumtime dhe Krijimin e Politikave (CRPM), Eko-vetëdija.

TEMA
**ANGAZHIMI
QYTETAR**

„Të drejtat e grave nuk janë të negociueshme” ishte motoja e marshit të 8 Marsit



Ndryshimet të fillojnë tani – apeloan pjesëmarrësit e marshimit për të drejtat e grave që u zhvillua këtë vit nën moton “Vija e kuqe: Të drejtat e grave nuk janë të negociueshme!”. Marshi tradicional i 8 Marsit i organizuar nga Platforma për Barazi Gjinore dhe aktivistët për të drejtat e grave me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas filloi në ora 17:00 në Sheshin Skënderbeu në Shkup.

Marshi mobilizoi qindra të pranishëm të cilët protestuan kundër pabarazive dhe padrejtësive ndaj grave dhe vajzave, duke rritur ndërgjegjësimin për nevojën për të avancuar të drejtat shëndetësore, arsimore, punëtore, kulturore, politike dhe ekonomike të grave. Aktivistët bënë thirrje për veprim, të motivuar nga trendi i erozionit së të drejtave të grave dhe përjashtimi i vazhdueshëm i tyre nga krijimi dhe miratimi i vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre.

Proklamata e këtij viti përcakton tetë vija të kuqe me të cilat përshkruhen ndryshimet e kërkuara:

1. **Trupi im, zgjedhja ime** – akses i pakufizuar në abortin mjekësor të sigurt dhe të ligjshëm në çdo komunë. Еднаква плата за еднаква работа
2. **Paga e barabartë për punë të barabartë** - kompensim i drejtë që do të pasqyrojë realisht vlerën e punës së gruas, si në vendin e punës ashtu edhe në shtëpi, dhe pagë të barabartë midis burrave dhe grave.
3. **Veprimi me vëmendjen e duhur ndaj institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore.**
4. **Të transformohet statusi i grave punëtore në kulturë,**

të cilat prej vitesh po përballen me pasiguri lidhur me statusin e tyre të punës.

5. **Përfaqësimi 50% i grave në pozitat e pushtetit** duhet të bëhet realitet.
6. **Zgjidhje sistematike** për aksesin në pushim të paguar të lehonisë dhe pushim mjekësor **për gratë fermere..**
7. **Shteti duhet të marrë masa energjike për gratë punëtore** dhe t’u sigurojë atyre kujdes për fëmijët e tyre që do t’u mundësojë atyre të marrin pjesë plotësisht në procesin e punës pa sakrifikuar rolin e tyre si prindër.
8. **Shteti duhet të investojë në luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit**, që prekin në mënyrë disproporcionale gratë dhe janë arsyeja kryesore e largimit të të rinjve nga vendi”.

Aktivistet theksuan se këto vija të kuqe nuk janë vetëm kërkesa, por janë edhe një udhërrëfyes për masat që mund të çojnë në progres. Prandaj, ata u bënë thirrje vendimmarrësve, politikanëve dhe partive politike që seriozisht t’i marrin parasysh këto kërkesa dhe të ndërmarrin hapa konkretë për realizimin e tyre, me qëllim të përmirësimit të pozitës së gruas dhe barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut.

Qytetarët dhe organizatat qytetare më shpesh janë ankuar për raportimin e gazetarëve

Këshilli për Etikën në Media e publikoi më 19 janar pasqyrën statistikore të vendimeve të Komisionit të Apelit për vitin e kaluar, 2023.


Pasqyra tregoi se Komisioni ka pranuar 132 ankesa për të cilat ka marrë 107 vendime dhe mendime. Në 61 prej tyre është shkelur Kodi i gazetarëve. Për 41 ankesa Komisioni ka konstatuar se janë të pabazuara, ndërsa për 20 ankesa nuk ka filluar procedura. Pesë nga ankesat u zgjidhën me pajtim ndërmjet palëve ose ndërmjetësim.

Sa i përket mediave që kanë qenë objekt i ankesave, nga shqyrtimi shihet se numri më i madh i referohet portaleve të internetit, gjithsej 110. Prej ankesave 10 janë në ueb faqet e televizioneve dhe gjashtë janë në vetë televizionet. Mediat e shkruara dhe botimet e tyre në internet janë më së paku të përfaqësuara, pra dy ankesa. Komisioni po ashtu thekson se për katër nga ankesat e pranura nuk ka iniciuar procedurë për shkak të mungesës së kompetencës.

Ankesat kanë të bëjnë me postimet në rrjetin social Facebook dhe në grumbulluesin e lajmeve Time.mk.

Ankuesit më të shpeshtë në vitin 2023 kanë qenë qytetarët me gjithsej 53 parashtresa. Pas tyre vijnë organizata dhe shoqata nga sektori civil me 35, media dhe gazetarë me 22 dhe partitë politike me 10. Të gjithë kërkuesit e tjerë kanë një numër një shifror ankesash, pra pesë janë nga kompanitë private, katër janë të përcaktuara si të tjerë, dy janë nga bartës të funksioneve publike dhe një përfaqësues ligjor.

Në info-grafikun e paraqitur tregon se cilët janë nenet më të shkelura të Kodit të gazetarëve. Më shumë se një e treta e shkeljeve janë për nenin 1, pra për postimin e informacionit të pasaktë dhe të pa verifikuar, mospasjen e “palës së dytë” dhe mungesën e të paktën dy burimeve të palidhura.



Tensionet partiake ndaj gazetarëve janë të panevojshme dhe joproductive

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) ka reaguar për deklaratën e kryetarit të LSDM-së dhe ish-kryeministrit, Dimitar Kovačevski, me të cilën akuzohen pa nevojë gazetarët, sidomos në periudhën parazgjedhore. Një fjalim i tillë negativ politik mund të çojë në rritjen e rrezikut të sulmeve ndaj gazetarëve dhe të pengojë të drejtën e qytetarëve për t'u informuar në mënyrë adekuate.

Veçanërisht alarmante ishin deklaratat e Kovačevskit në një ngjarje partiake më 19 shkurt, kur ai drejtoi fjalë fyese ndaj gazetarëve dhe nënkuptoi manipulim politik të mediave, thuhet në njoftimin e SHGM-së.

SHGM-ja e thekson rëndësinë që politikanët t'i adresojnë shqetësimet rreth mbulimit mediatik përmes kanaleve të duhura, siç janë organet vetërregulluese të mediave, përkatësisht:

Këshilli i nderit në SGM-së si dhe Këshilli për Etikën në Media të Maqedonisë në vend që të përdorin sulme personale. Ata theksojnë gjithashtu se është krijuar një organ i ri koordinues, në bashkëpunim me Zyrën për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), për të monitoruar respektimin e Kodit të sjelljes në hapësirën online gjatë zgjedhjeve.

Ky organ do të vendosë për ankesat për dezinformata, gjuhën e urrejtjes dhe sjellje të tjera joetike në internet dhe ato mund të dërgohen në koordinativnotelozaizbori@avmu.mk.

SHGM u bën thirrje të gjitha partive politike që të respektojnë rolin e gazetarëve dhe të mbështesin lirinë dhe profesionalizmin e medias, thelbësore për një shoqëri demokratike dhe zgjedhje të ndershme.

Nxënësit e shkollave të mesme nga SHTIPI DHE Sveti Nikoleja mësuhan për dhunën e bashkëmoshatarëve



Nxënës nga tri shkolla të mesme nga Shtipi morën pjesë në punëtoritë për dhunën e bashkëmoshatarëve të udhëhequr nga edukatorja për të rinjtë Dragana Mitroviq. Përmes përmbajtjes, ata u zhytën në dinamikën e bullizmit dhe i hulumtuan strategjitë e parandalimit dhe ndërhyrjes.

Përmes lojës me role, punës në grupe, prezantimeve dhe aktiviteteve të tjera, nxënësit e shkollave të mesme “Sllavço Stojmenski”, “Kole Nehtenin” dhe “Jane Sandanski” nga Shtipi diskutuan për dinamikën e bullizmit dhe strategjitë e përballimit, si ta njohin dhe të reagojnë ndaj dhunës së bashkëmoshatarëve. Duke vepruar kështu, u theksua roli i tyre si vëzhgues dhe çfarë mund të bëjnë ata si studentë.

Në punëtorinë në Sveti Nikole morën pjesë 19 studentë nga SHMK “Koço Racin” të cilët hulumtuan se si të identifikohet dhe t’i rezistojë dhunës së bashkëmoshatarëve, duke u marrë me kompleksitetin e ndryshimit të roleve midis dhunuesit dhe viktimës.

Nën udhëheqjen e Mitroviq, ata krijuan plane për t’u marrë me dhunën e bashkëmoshatarëve në komunitetet e tyre shkollore.

Edukatorët e trajnuar të bashkëmoshatarëve gjatë vitit shkollor do të kenë mundësinë të bisedojnë me bashkëmoshatarët, të transferojnë njohuri dhe të diskutojnë se si të parandalohet përhapja e dhunës nga bashkëmoshatarët. Këto përpjekje i inkurajojnë të rinjtë që t’i kundërvihen bullizmit dhe të promovojnë një kulturë respekti dhe ndjeshmërie midis bashkëmoshatarëve të tyre.

Punëtoritë për edukatorë të bashkëmoshatarëve u realizuan nga shoqata “Media Plus” nga Shtipi në kuadër të projektit “Siguria është motoja jonë”, i cili pjesërisht mbështetet nga Ambasada Amerikane në Shkup.

Trajnim për trajnues për të rinjtë

Nga data 13 deri më 15 shkurt 2024, Qendra për Hulumtime dhe Krijimin e Politikave (QHQP) mbajti trajnim për trajnues në Veles, Maqedoni. Në partneritet me CARE International dhe Qendrën për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime, janë trajnuar 20 të rinj, përfaqësues nga organizatat partnere të rinjtë munden, Shoqata e Organizuar Rinore, Shoqata Kreativ/ Asociacioni Rimor Kreativ Kavadar, Fondacioni për Zhvillimin e Komunitetit Lokal - Shtip dhe Shoqata Akua.

U trajtuan tema nga Programi M. Puna me burra dhe djem për të sfiduar pabarazinë gjinore mund të ketë një ndikim pozitiv në shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe vajzave. Ekziston gjithashtu një kuptim në rritje sesi idealet e ngurta të gjinisë dhe maskulinitetit mund të çojnë në dobësi specifike për burrat dhe djemtë. Me Programin Y – fokusi ishte transformimi i mjedisit shkollor në një mjedis që mbështet dhe ushqen barazinë gjinore dhe promovon një kulturë të jo-dhunës. Me njohuritë e fituara,

edukatorët e bashkëmoshatarëve nga organizatat rinore të shoqërisë civile do t’i zhvillojnë punëtoritë në komunitetet e tyre lokale.

Edukatorët i përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese, thelluan njohuritë e tyre për parandalimin e dhunës nga bashkëmoshatarët, etiketimin dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të alkoolit dhe drogës. Këto tema do të jenë pjesë e punëtorive të tyre të ardhshme me nxënës të shkollave të mesme që do të zhvillohen në shkolla apo qendra rinore. Në ditën e fundit të trajnimit, pjesëmarrësit i vizitoi Ambasadori i Holandës, i cili mori pjesë aktive në sesionin ku edukatorët e bashkëmoshatarëve zhvilluan punëtori.

Në fund të trajnimit, Ambasadori u ndau certifikata pjesëmarrësve për përfundimin e trajnimit.

Historia e Ilinës e treguar në Kombet e Bashkuara në Gjenevë

Me promovimin e “Historia e Ilinës: Krahët e saj janë bërë nga dashuria” në misionin e përhershëm të Maqedonisë së Veriut në Gjenevë, u shënua 21 marsi Dita Botërore e personave me sindromën Daun. Autorja e tregimit është nëna e Ilinës, Mimoza Petreska Georgieva, ndërsa ilustrimi është i babait të saj, Pero Georgiev. Dr. Teuta Agai Demjaha, ambasadore në Misionin e Përhershëm të RMV-së në Gjenevë, foli në këtë aktivitet.

Ilina 20-vjeçare, një vajzë me sindromën Daun, është një person ambicioz, punëtore, e hapur, këmbëngulëse, që me energjinë e saj pozitive dhe shpirtin e ekipit, lë mbresa të forta te të gjithë ata që e takojnë. Këndimi dhe kërcimi janë dashuria dhe obsesioni i saj dhe me dëshirë të madhe, vendosmëri dhe këmbëngulje të madhe arrin të përmirësohet edhe në not, për të cilin mund të mburret me medaljet e vendit të parë dhe të dytë në disa gara.

Gjatë prezantimit të historisë, Ilina foli për veten dhe performoi një kërcim solo. Videoja është realizuar në kuadër të fushatës “Ndoshta jemi ndryshe, por të gjithë jemi të talentuar” të Ambasadës së Parë të Fëmijëve në botë, Megjashi. Ajo tregon vetëm një pjesë të vogël të përditshmërisë emocionuese të Ilinës.

Kjo vajzë e re pozitive u zhvendos në Zvicër një vit më parë. Ilina nis rrugëtimin e integritetit në shtëpinë e saj të re, duke bërë hapa të sigurt përpara me vendosmëri dhe qëndrueshmëri.



Të flasim më shumë për mjedisin në një kohë të krizës mjedisore në rritje

Maqedonia është e kërcënuar nga ndotës të ndryshëm. Ndotja e ajrit është një nga më të lartat në Evropë, një sasi e madhe mbetjesh nuk riciklohet, cilësia e ujit po përkeqësohet, ka prerje të tepërt të pyjeve, biodiversiteti kërcënohet nga zhdukja dhe ndryshimet klimatike po ndikojnë në prodhimin e ushqimit. Në një krizë të tillë mjedisore në rritje, institucionet publike, bizneset, organizatat e shoqërisë civile, media dhe sektori akademik duhet të marrin gjithnjë e më shumë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe të komunikojnë për mjedisin.

Në këtë mënyrë do të rritet ndërgjegjësimi dhe kuptimi i çështjeve komplekse mjedisore, gjë që do të forcojë rolin e qytetarëve dhe organizatave në ruajtjen e mjedisit.

Kështu u tha në konferencën “Si të komunikojmë për mjedisin në krizën mjedisore në rritje: përvoja praktike dhe perspektiva të reja”, të cilën Instituti për Studime të Komunikimit e organizoi më 27 mars 2024 në Shkup.

Në fjalën hapëse, Dejan Andonov, koordinator i programit në ISK, deklaroi se komunikimi efektiv mund të ndihmojë në avokimin e politikave, ndryshimin e sjelljes së njerëzve, zgjidhjen e konflikteve dhe miratimin e ligjeve mjedisore. Presidenti i Asociacionit Ndërkombëtar për Komunikim Mjedisor, Stiv Depo, thotë se nga njëra anë është retorika

që mbështet mbishfrytëzimin e burimeve dhe fitimit dhe është skeptik ndaj shkencës dhe qëndrueshmërisë, dhe nga ana tjetër janë ata që flasin për emergjencat klimatike dhe kërcënime ekzistenciale me emocione zemërimi dhe frike.

Shumë më pak e përhapur është retorika mjedisore e bazuar në interpretimin dhe kuptimin shkencor.

Është e rëndësishme që aktivistët, nëpunësit publik, shkencëtarët, gazetarët dhe komunikuesit profesionistë të dinë se si të adresojnë, hulumtojnë, shpjegojnë dhe shpërndajnë informacione rreth problemeve mjedisore për një audiencë të gjerë. Në këtë drejtim, përvojën e afirmimit të mbrojtjes së rrëqebullit ballkanik për publikun e përcolli Dime Melovski nga Shoqata Ekologjike e Maqedonisë. Ai theksoi se programi për rikuperimin e rrëqebullit të Ballkanit ka nisur 18 vite më parë.

“Të dhënat që i kemi marrë me kapjen e rrëqebullit na ndihmojnë në zhvillimin e planeve të veprimit dhe konservimit për mbrojtjen e rrëqebullit, ndërsa faza e ardhshme do të ketë për qëllim forcimin e gjenetikës së rrëqebullit”, tha Melovski.



“Na duhen gjenerata të ardhshme që e kuptojnë këtë problem dhe që do të kenë një ndërgjegjësim të zhvilluar. Ne përqipemi t’ua paraqesim problemet mjedisore në mënyrë të kuptueshme për të shmangur eko-ankthin - kur ata nuk dinë se si duhet të veprojnë në lidhje me këto probleme djegëse”, tha Mila Jovanovska nga “Go Green”.

Konferenca diskutoi gjithashtu nevojën për të promovuar zgjidhje të bazuara në natyrë për të ndërtuar komunitete rezistente ndaj klimës, kompanitë për t’u pozicionuar më mirë me përgjegjësinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore, dhe ndikuesit e mediave dhe mediave sociale për të ndihmuar në kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve

mjedisore.

Konferenca u realizua në kuadër të projektit “Popullarizimi i komunikimit mjedisor përmes mësimi online dhe lëvizshmërisë virtuale”, i cili zbatohet nga Instituti për Studime të Komunikimit në partneritet me universitetet e Novi Sadit, Zagrebit, Sarajevës dhe Tiranës.

Projekti financohet nga programi ERASMUS+ nëpërmjet Agjencisë Kombëtare për Programet Arsimore Evropiane dhe Mobilitet.

15 Marsi – Dita Botërore e të Drejtave të Konsumatorëve

Dita Botërore e të Drejtave të Konsumatorëve këtë vit e vuri në qendër të vëmendjes Inteligjencën Artificiale (AI) përmes fushatës: “Inteligjencë artificiale e drejtë dhe e përgjegjshme për konsumatorët”.

Fushata e theksoi nevojën për vëmendje më të madhe për ndërtimin dhe zhvillimin e modeleve të AI, veçanërisht për mbledhjen e ligjshme të të dhënave, me pëlqimin e njerëzve ose pronarëve të të drejtave intelektuale, si dhe ndaj etikës së punës njerëzore që i shënon dhe i kategorizon këto të dhëna.

Në fakt, ai bazohej kryesisht në Ligjin për Inteligjencën Artificiale, i cili u miratua nga Parlamenti Evropian më 13 mars 2024. Ai duhet të sigurojë kushte më të mira për zhvillimin dhe përdorimin e Inteligjencës Artificiale (AI), si dhe sigurinë, transparencën dhe mosdiskriminimin nga këto sisteme. Ligji përcakton sistemet e AI sipas nivelit të rrezikut, me rregulla të reja për sistemet me rrezik të lartë dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të AI që duhet të ndalohen plotësisht, siç është identifikimi biometrik në vende publike.

Organizata Botërore e Konsumatorëve (Consumers’ International) e shënon Ditën Botërore të të Drejtave të Konsumatorëve, të njohur nga Kombet e Bashkuara, dhe ka bërë fushatë për të drejtat e konsumatorëve për më shumë se 40 vjet, duke bashkuar lëvizjen e konsumatorëve



në aktivitete të përbashkëta për të rritur ndërgjegjësimin global për të drejtat dhe nevojat e konsumatorëve.

OKM si anëtare i është bashkuar fushatave për dekadën e tretë.

Arsimi i lartë duhet të integrohen në rrjedhat ekonomike

Forumi për Politika të Arsyeshme, në bashkëpunim me organizatat partnere Institutin për Shkenca Sociale dhe Humane dhe Institutin Ballkanik për Bashkëpunim Rajonal, më 27 mars 2024 e mbajtën forumin tematik me titull “Pamje e dendur: mbi nevojën për rrjetëzimin e arsimit, shkencës dhe ekonomisë e bazuar në inovacion”.

Në forum u diskutua për angazhimet e mëparshme për arsim të lartë cilësor dhe hapat e ardhshëm që do të çojnë në krijimin e një klime të përshtatshme për përfaqësim më efektiv.

“Ekzistojnë njeje burokratike dhe ato nuk janë të pazgjidhshme, përkundrazi,” tha Gordan Georgiev nga Forumi për Politika të Arsyeshme. Ai theksoi se planifikojnë t’i japin alarmin qeverisë së re dhe të vënë në dukje gjërat që mund të bëhen shpejt, si dhe të inkurajojnë dhe motivojnë njerëzit e mirë në administratën shtetërore. Sipas Ana Shopovska nga Kuvendi i Universitetit, është e nevojshme të rritet atraktiviteti i studimit. “Shteti duhet të sigurojë akomodim, bursa dhe programe më të mira për studentët, por edhe programe në gjuhën angleze, veçanërisht në studimet universitare”, tha ajo dhe u bëri thirrje kompanive që të përfshijnë studentët në procesin e prodhimit gjatë praktikës së tyre që do t’i ndihmonte ata të mësojnë aftësitë e nevojshme.

Aleksandar Bogojevski nga Agjencia Kombëtare për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet foli për rëndësinë e bashkëpunimit në nivel të Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, rëndësi të madhe janë fondet e përbashkëta, mbështetja në projekte kërkimore, njohja automatike e diplomave dhe krediteve të fituara. “Krijimi i programit studimor duhet të bëhet në bashkëpunim me komunitetin ndërmarrës dhe të gjithë kemi përgjegjësi



të madhe në atë proces”, tha profesori Kiril Barbareev nga Universiteti “Goce Dellçev” nga Shtipi.

Të pranishmit diskutuan për arsimin e lartë, i cili duhet të integrohet thellësisht në flukset ekonomike brenda dhe jashtë vendit, në të cilin hulumtimi dhe shkenca do të rrjedhin dhe do të jenë pjesë e domosdoshme e ndërtimit të politikave publike në vend dhe në të cilin do të gjejnë studentët e rinj të suksesshëm një strehë të mirë dhe të sigurt akademiko-ekonomike, dhe në këtë mënyrë për të reduktuar ikjen e trurit.

Forumi tematik është pjesë e projektit “Avokimi për zhvillim gjithëpërfshirës”, i mbështetur nga Qeveria e Zvicrës përmes programit Civica mobilitas.

Monitorimi qytetar për aksesin e vendvotimeve

Vitin e kaluar, Gjykata Themelore Civile në Shkup nxori një aktgjykim që vërtetoi diskriminimin e drejtpërdrejtë të kryer nga Qeveria e RMV dhe Komisioni Shtetëror Zgjedhor ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Këto institucione nuk kanë ndërmarrë veprime për të rregulluar aksesin e qendrave të votimit në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë aktive dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Në aktgjykim, gjykata e obligon Qeverinë e RMV-së dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, deri në shpalljen e ciklit të ardhshëm zgjedhor, të parashikojnë masa që do t’u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtën e votës në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë. Gjithashtu, Komisioni për

Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) në disa raste ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara në proceset e pjesëmarrjes në jetën politike.

Në vitin 2021, KPMĐ lëshoi një Rekomandim të përgjithshëm duke rekomanduar Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në kohën më të shkurtër të mundshme dhe të sigurojë akses dhe përshtatje të përshtatshme të vendvotimeve, të cilat do të mundësojnë qasje të barabartë për personat me aftësi të kufizuara fizike në dhe në qendrat e votimit në të gjithë qendrat e votimit. Zgjedhjet e këtij viti janë të parat pas vendimit të Gjykatës Themelore Civile. Prandaj,

MCMS së bashku me KPMD-në kanë nisur një iniciativë për monitorimin civil të aksesit në vendvotime gjatë zgjedhjeve.

Për përfshirje në këtë iniciativë MCMS dhe KPMD kontaktuan 88 organizata të shoqërisë civile që punojnë ose përfaqësojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Përfaqësuesit e këtyre organizatave u ftuan të marrin pjesë duke monitoruar aksesin e qendrave të votimit nga roli i votuesve kur ata dalin për të ushtruar të drejtën e tyre të votës. Për nevojat e monitorimit u përgatit pyetësori për aksesueshmërinë e qendrave të votimit dhe udhëzimi me udhëzime më të detajuara.

Pyetësori është i disponueshëm në gjuhën maqedonase dhe shqipe në versionet online dhe word.

Të dhënat që do të mblidhen gjatë raundit të parë dhe të dytë zgjedhor do të përmbledhen dhe do t'i shërbejnë KPMD-së për të perceptuar situatën reale në terren dhe më pas në krijimin e mekanizmave parandalues dhe mbrojtës

për përmirësimin e kushteve për pjesëmarrje reale politike të njerëzve me aftësi të kufizuara gjatë zgjedhjeve.

Pyetësori në maqedonisht || Pyetësori në shqip

Krahas kësaj iniciative, KPMD, me mbështetjen e MCMS-së, ka përgatitur edhe një video të shkurtër promovuese me të cilën kanë dërguar mesazhe të qarta për bashkim kundër gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës shqetësuese. Aspirantëve për pushtet, votuesve dhe të gjitha palëve të tjera të përfshira u kërkohet të mos përdorin gjuhë fyese. Seksizmi, përhapja e paragjykimeve dhe urrejtjes ndëretnike, përdorimi i grupeve të marginalizuara për të frikësuar dhe bashkuar në urrejtje, nuk do të thotë liri e fjalës. Anëtarët e KPMD-së bëjnë thirrje që të përmbahen nga komentet e urrejtjes dhe/ose transmetimi i përmbajtjeve të tilla. Qoftë online apo offline, ne të gjithë duhet të veprojmë me përgjegjësi për të parandaluar përhapjen e gjuhës së urrejtjes gjatë zgjedhjeve.

Претставници на БЦСДН ќе учествуваат во работата на ЕЕСК

Katër përfaqësues të shquar nga Rrjeti Ballkanik i Zhvillimit të Shoqërisë Civile (BCSDN) do të jenë pjesë e Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KEES) si përfaqësues të shoqërisë civile nga nëntë vendet kandidate për në BE. Biljana Spasovska, drejtore ekzekutive e BCSDN; Juliana Hoxha, drejtore ekzekutive e Partnerëve Shqipëri (Partners Albania); Aida Daguda, drejtore ekzekutive e Qendrës për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD) BeH; dhe Gynesh Engin Karamanxhi (Güneş Engin Karamanci), koordinator i projektit nga TUSEV (Turqi) marrin pjesë për herë të parë në debatet plenare të KEES-së, duke e pasuruar dialogun me perspektiva dhe ekspertizë të ndryshme.

Përfshirja e tyre e thekson rolin kyç të BCSDN në avancimin e zërit të shoqërisë civile dhe demokracisë në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Iniciativa për anëtarët-kandidatë për zgjerim, e mbështetur nga Presidenti i KEES, Oliver Ropke, është një pilot projekt pionier që synon integrimin e vendeve kandidate në Bashkimin Evropian duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave qytetare (OQ) dhe KEES-së. Përmes pjesëmarrjes aktive në hartimin e opinioneve, angazhimit në grupe studimore dhe kontributit në seancat plenare, përfaqësuesit e OQ-ve do të luajnë një rol jetik në formësimin e politikave dhe iniciativave të BE-së në lidhje me zgjerimin, Tregun unik, Marrëveshjen e gjelbër dhe Shtyllën evropiane të të drejtave sociale.

„Како БЦСДН, чест ни е што сме признаени од ЕЕСК “Si BCSDN, ne jemi të nderuar që jemi njohur nga KEES dhe të kontribuojmë në këtë nismë. Kjo e thekson rolin tonë në forcimin e shoqërisë civile dhe mbrojtjen e lirive të qytetarëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”, thotë Biljana Spasovska. Kjo nismë jo vetëm që e përmirëson procesin demokratik në zgjerimin e BE-së, por është

gjithashtu një hap i rëndësishëm drejt promovimit të lirisë, demokracisë dhe prosperitetit socio-ekonomik në vendet kandidate.

Maqedonia e Veriut do të ketë 14 përfaqësues në KEES.

1. Biljana Spasovska nga BCSDN;
2. Branko Azeski, Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veut;
3. Trajan Angeloski, Unioni i Odave Ekonomike të Maqedonisë;
4. Valentina Disoska, Shoqata e Grave Afariste;
5. Lazar Nedanoski, Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (MRFP);
6. Blagoja Ralpovski
7. Jakim Nedelkov
8. Zoran Dionisijev
9. Daniela Janevska,
10. Sanela Donevska Andonovska, Konfederata e Sindikatave të Lira të Maqedonisë (KSS);
11. Blagica Petreski, Finance Think
12. Simonida Kacarska, Instituti i Politikave Evropiane (IPE);
13. Denis Selmani, Instituti për Hulumtime dhe Analiza të Politikave – Romalitiko;
14. Zoran Drangovski, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (SHMJR).

IPE prezantoi në para-sesionin e 46-të të ciklit të katërt të PPU

Angela Delevska dhe Ardita Vejseli, hulumtuese në Institutin e Politikave Evropiane (IPE) morën pjesë në para-sesionin e 46-të të ciklit të katërt të Pasqyrës Periodike Universale (PPU) në zyrat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Zvicër, i cili u mbajt nga data 13 deri më 16 shkurt të këtij viti.

Delevska e prezantoi deklaratën e IPE-së e cila mbulon dy çështje aktuale, sfidat dhe pengesat për pavarësinë dhe pluralizmin e organit kombëtar për barazi, përkatësisht Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (KPMD); dhe sfidat dhe shkeljet e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të personave me aftësi të kufizuara, pra të drejtën për arsim gjithëpërfshirës.

Ajo iu referua pengesave me të cilat përballlet KPMD si kufizimet financiare, mungesa e pavarësisë së burimeve njerëzore dhe presioni nga partitë politike në përzgjedhjen e anëtarëve, gjë që kërcënon pavarësinë dhe efektivitetin e saj. Sa i përket çështjes së dytë, edhe pse është bërë progres me miratimin e ligjeve dhe koncepteve për arsimin gjithëpërfshirës, zbatimi ka mbetur prapa. Çështjet kryesore përfshijnë stafin e pamjaftueshëm mbështetës, sigurimin e pamjaftueshëm për të mësuar gjuhën Braille dhe gjuhën e shenjave, dhe pengesat për aksesin në objektet arsimore.

Delevska dhe Vejseli zhvilluan edhe disa takime avokuese me përfaqësues të misioneve të përhershme në OKB të Gjermanisë, Belgjikës, Suedisë dhe Kroacisë. Përveç kësaj, ata patën një takim avokues me delegacionin e BE-së në Gjenevë.

YPPU është i vetmi mekanizëm ndërkombëtar i Këshillit



të të Drejtave të Njeriut që i bën thirrje çdo shteti anëtar të OKB-së t'i nënshtrohet një auditimi të të dhënave të të drejtave të njeriut çdo 4.5 vjet. PPU është themeluar në vitin 2007 dhe sesioni i parë është mbajtur në vitin 2008.

Meqenëse PPU-ja është një mekanizëm gjithëpërfshirës, konsultimet me aktorë të tjerë si organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ-të) dhe aktorë të tjerë lokalë mbahen në para-sesione, të organizuara një muaj përpara shqyrtimit të Grupit të punës. Ato ofrojnë mundësinë që përfaqësuesit e misioneve të përhershme të mbledhin informacion të plotë dhe të përditësuar në një periudhë të shkurtër kohore përmes takimeve me disa organizata të shoqërisë civile në të njëjtën kohë.

U prezantua hulumtimi për gjendjen me vetërregullimin e medias në vend

Për të përmirësuar funksionimin dhe efektivitetin e vetërregullimit të medias në vend, është i nevojshëm forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të organeve vetërregulluese, veçanërisht kur zgjidhen problemet etike që dalin nga mjedisi digjital, përditësohen rregullisht kornizat etike dhe përmirësohen mekanizmat për vetëqëndrueshmërinë e tyre afatgjatë. Gjithashtu, nevojiten më shumë iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për funksionimin e mekanizmave vetërregullues.

Këto ishin konkluzionet kryesore që dolën nga paneli "Rëndësia e vetërregullimit të mediave për avancimin e standardeve profesionale" organizuar nga Instituti Maqedonas për Media në kuadër të projektit rajonal "Media jonë: Iniciativa për avancimin e shkrim-leximit mediatik, dialogu dhe aktivizmi", i cili financohet nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër të ngjarjes u prezantuan gjetjet kryesore të hulumtimit "Vetërregullimi i mediave në Maqedoninë e

Veriut: Përforsimi i domosdoshëm i mekanizmave dhe përmirësimi i efektivitetit" i përgatitur nga hulumtuesit e MIM, Marina Tuneva dhe Vesna Nikodinoska. Analiza fokusohet në dokumentet kyçe etike dhe analizon kapacitetet, sfidat dhe praktikën e mira që rrjedhin nga funksionimi i mekanizmave përkatës në këtë fushë, veçanërisht në mjedisin digjital. Eventin e hapi Dejvid Gir, shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian, i cili ndër të tjera theksoi se Komisioni Evropian inkurajon vetërregullimin e mediave dhe legjislacionin i Maqedonisë do të duhet të përputhet me rregullat evropiane në këtë fushë. Fjalë hyrëse mbajtën Mlladen Čadikovski, kryetar i Shoqatës të Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Leunora Kaliqi, kryetare e Bordit të Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë (KEMM).

Rëndësia e vetërregullimit të mediave për promovimin e standardeve profesionale, përfshirë edhe në periudhat parazgjedhore, ishte temë e diskutuar nga Aneta Andonova, kryeredaktore e Shërbimit të parë programor

të Televizionit të Maqedonisë, Mirçe Adamçevski, kryetar i Komisioni për ankesa në KEMM, Sashe Dimovski, kryetar i Këshillit të nderit në SHGM dhe Dragica Ljubevska, shefe e departamentit në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Komunat nënshkruan deklaratë për mbrojtje aktive të mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike



Kryetarët e komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, më 31 janar të këtij viti, nënshkruan Deklaratën për mbrojtje aktive të mjedisit jetësor dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke konfirmuar përkushtimin për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm urban, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësinë e jetës për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Manifestimin me temën “Qasja lokale për mbrojtjen aktive të mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike” e hapi Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Kaja Shukova, e cila theksoi se është e kënaqur që ndërgjegjësimi i komunave për mjedisin po rritet, e cila mund të konkludohet pas numrit të kryetarëve të komunave të pranishëm në aktivitet.

“Me nënshkrimin e kësaj Deklarate për Agjendën e Gjelbër 2020, administrata qendrore dhe vendore marrin përsipër angazhimin në nivel kombëtar dhe lokal për të realizuar angazhimet e dokumentit, ndërsa zbatimi është kryesisht në nivel lokal. Prandaj është e nevojshme që komunat të marrin pjesë plotësisht në realizimin e obligimeve dhe detyrave dhe të marrin masa në përputhje me Agjendën e Gjelbër”, theksoi ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Kaja Shukova.

Njëkohësisht ajo shprehu bindjen se do të vazhdojë realizimi i aktiviteteve në të cilat do të përfshihen bashkërisht autoritetet qendrore dhe lokale.

“Kjo, para së gjithash, për shkak të nevojës për forcimin e kapaciteteve administrative të vetëqeverisjes lokale dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e mjedisit jetësor dhe për arsye se për vetëqeverisjen lokale sfida mbetet përballja me një numër edhe më të madh të aktiviteteve që duhet të ndërmerren në drejtim të ruajtjes së mjedisit në nivel lokal”, shtoi ministria.

Në këtë aktivitet u prezantuan obligimet e komunave nga Agjenda e gjelbër për Ballkanin Perëndimor përmes një ekspozimi të aktiviteteve dhe mundësive për financim në nivel lokal, si dhe mundësitë e komunave për përgatitjen e planeve për energji dhe klimë të qëndrueshme.

Ngjarja organizohet si pjesë e projektit “Organizatave civile në veprim për ndryshimet klimatike” të zbatuar nga Eko-vetëdija, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (SHMJR) dhe Organizata për Lidhjen e Vlerave Natyrore dhe Njerëzit - CNVP, dhe financiarisht është mbështetur nga Qeveria e Suedisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – Sektori për Bashkëpunim me Vetëqeverisjen Lokale dhe Çështjet Administrative dhe Mbikëqyrëse.

Unifikimi i 11 organizatave civile dhe krijimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve sociale



Më 17 janar 2024, në ambientet e Qendrës Edukative M6, 11 organizata të shoqërisë civile, ofrues të shërbimeve sociale, nisën formimin e “Rrjetit formal të ofruesve të shërbimeve sociale”. Organizatat: SOS Fshati i Fëmijëve, “Humaniteti”, Hera, Poraka - Negotinë, Qendra e Krizave “Nadezh”, Porta e Hapur, Montessori, HOPS, Inkluziva, Shoqata e personave me paralizë cerebrale dhe aftësi të kufizuara të tjera - Veles dhe KRIK, të cilët janë ofrues të shërbimeve sociale ose punojnë në mbrojtjen sociale, me këtë iniciativë duan të forcojnë veprimin dhe ndikimin e tyre në interes të kategorive të cënueshme që mbështesin dhe t’u ofrojnë shërbime sociale cilësore.

Eventi u mbështet edhe nga përfaqësues të lartë të institucioneve ndërkombëtare, si Stefan Hudolini (Steffen Hudolin), shef i bashkëpunimit në Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shkup, Rosana Duxhiak, Koordinatorë e Përhershme e OKB-së në Maqedoninë e Veriut dhe Harold Fuger, Ambasador për Çështje Sociale të Ministrisë austriake për çështje sociale, shëndetësi, kujdes dhe mbrojtje të konsumatorëve. Ata morën pjesë në panel diskutim, inkurajuan dhe dhanë mbështetje organizatave të shoqërisë civile për realizimin e kësaj ideje.

Në panel mori pjesë edhe Flakron Bexheti, Sekretar shtetëror në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, i cili e konfirmoi rëndësinë e punës së organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht pas procesit të deinstitutionalizimit dhe reformave sociale në kuadër të Strategjisë Kombëtare “Trimza”, e cila është zbatuar për më shumë se 70 %. Këto ndryshime u kanë mundësuar organizatave të shoqërisë civile që të përfshihen në ofrimin e shërbimeve sociale

– diçka që deri më tani ishte përgjegjësi vetëm e shtetit, dhe me përvojat dhe ekspertizën e tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shërbimeve të reja të rëndësishme për qytetarët, por edhe për përmirësimin cilësinë e atyre ekzistuese. Sot, 82 organizata janë ofrues të shërbimeve sociale me kapacitet për t’u shërbyer mbi 3400 përfituesve, 80% e të cilëve mbështeten nga fondet shtetërore. Këto organizata ofrojnë shërbime si: kujdesi për personat me aftësi të kufizuara, kujdesi për jetimët dhe kujdesi prindëror, asistencë personale, qendra ditore, mbështetje për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, shërbime këshillimi etj.

Në këtë ngjarje folën edhe Mario Jançev, drejtor i zhvillimit të programit në SOS Fshatin e Fëmijëve dhe Elizabeta Bozhinoska, drejtoreshë programore nga HERA, të cilët shpjeguan pse është i nevojshëm unifikimi dhe aksioni i përforcuar i ofruesve të licencuar të shërbimeve sociale. U dha një pasqyrë e reformës sociale bazuar në decentralizimin, deinstitutionalizimin dhe pluralizimin e sistemit të mbrojtjes sociale. Është pluralizimi që siguron legjitimitetin për diversifikimin e shërbimeve sociale nga ofruesit e shërbimeve sociale joshëtetërore dhe shoqërimin e tyre që do të rrisë ndikimin dhe dialogun ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe krijuesve të politikave. Nevojitet një mjedis mbështetës për ofrimin cilësor të shërbimeve sociale në vend dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e shërbimeve sociale ekzistuese, si dhe për të stimuluar hapjen e të rejave në rajonet ku ka mungesë të shërbimeve sociale.

LAJME
**NGA CIVIKA
MOBILITAS**

Përfunduan sesionet informative për thirrjen e re për grantet e Civika mobilitas



Nga 5 deri më 15 mars 2024, ekipi i Civika mobilitas udhëtoi mbi 2000 kilometra, vizitoi tetë rajone planifikuese dhe mbajti nëntë sesione informative kushtuar thirrjes për Grante për angazhim qytetar. Mbi 130 përfaqësues të interesuar të organizatave të shoqërisë civile ishin pjesë e sesioneve në Kriva Pallankë, Shtip, Strumicë, Gostivar, Veles, Strugë, Manastir dhe Shkup.

Shumica e sesioneve informative iu kushtuan pyetjeve të pjesëmarrësve. Krahas interesit për sqarimin e disa kriterëve për paraqitjen e aplikimeve dhe mënyrën e plotësimit të dokumenteve të detyrueshme, takimet u përdorën edhe për të shkëmbyer përvojat e partneriteteve të mëparshme, për të diskutuar mbi problemet urgjente të organizatave në rajon, si dhe për idetë fillestare për projekte.

Sipas Risto Kamov, kryetar i organizatës Changemakers nga Gjevgjelia, kjo qasje, e cila mund të ndërtojë bashkëpunim afatgjatë ndërmjet organizatave nga rajonet, është shumë e mirë. “Deri më tani kemi pasur përvojën e punës së përbashkët gjatë zbatimit të aksioneve, por asnjëherë nuk kemi pasur mundësi të punojmë së bashku në një projekt afatgjatë. Mendoj se është një mundësi e shkëlqyer për të bashkuar forcat për të bërë diçka më shumë”, tha ai.

Pjesëmarrësit shprehën kënaqësinë që sesionet informative u mbajtën në secilin rajon, gjë që lehtësoi aksesin e tyre dhe u dha atyre mundësinë për t'u mbledhur, rrjetëzuar dhe diskutuar çështje të rëndësishme për organizimin qytetar në rajonin specifik.

Për sa i përket dokumenteve të nevojshme për paraqitjen e aplikimeve, të pranishmit shprehën interes për bashkëngjitjen që i referohet ndikimit në mjedis (Cedrig light) e cila shërben si filtër për vlerësimin e kërcënimeve të mundshme që projekti mund të shkaktojë mbi ambientin mjedisor. Ata që tashmë kanë pasur rastin ta takojnë, theksuan se injorimi i këtyre rreziqeve zgjat kohëzgjatjen e veprimeve.

Të gjitha sesionet informuese janë mbajtur në hapësira publike. Falënderojmë kolegët nga zyrat e Shtëpisë së Evropës (Europe House) në Kriva Pallankë, Veles dhe Strumicë, në Këndin amerikan në Strugë, në qendrën “Mladi Hab” në Manastir dhe në Qendrën e Burimeve Qytetare në Shtip, Gostivar dhe Shkup për hapësirën dhe mikpritjen.

QYTETARËT PËR NDRYSHIME

Kryeredaktor: Gonca Jakovleska

Redaktor: Karolina Gjurovska

Adresa e Botuesit: Rr. Nikolla Parapunov nr. 41a, f.p 55, 10160 Shkup

Tel: ++ 389 (0)2 3065 381

e-mail: helpdesk@civicamobilitas.mk



„Qytetarët për ndryshim“ e boton programi Civica Mobilitas i mbështetur financiarisht nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), implementuar nga NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe FCG nga Suedia.

Artikujt e botuar në këtë revistë shprehin pikëpamjet e autorëve dhe/ose organizatave që kontribuojnë në revistë, por jo ato të Ambasadës Zvicerane/Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim ose ato të organizatave implementuese: NIRAS, MCMS ose FCG.

www.civicamobilitas.mk